



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:274224

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05803884

KPPP.nr.656/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “NB COMPANY / NOTI BETON” SH.P.K., me NUI: 810727563, me seli në Fshatin Llazarevë, në Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Gëzim Hoti dhe Pranvera Alshiqi – Maloku, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.961/21 të datës 10.11.2021, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 10.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.961/21 të datës 10.11.2021, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.961/21 i datës 10.11.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përfaqësim, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 270.40 € (dyqind e shtatëdhjetë euro e katërdhjetë cent) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.961/21 të datës 10.11.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 10/2021 të datës 17.09.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguajë kreditorit në emër të pjesës së mbetur të obligimit të papaguar sipas faturës së lartcekur shumë prej 13,978.22 €, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, ashtu që përmbartja e detyrimeve të realizohet përmes llogarisë së debitorit në Ministrinë e Financave me transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të saj, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar ndër të tjerash se fatura e bashkëngjitur së bashku me propozim nuk është dokument përmbartues në bazë të cilës mund të ushtrohet përmbartimi, pasi që është e njëanshme dhe është nënshkruar vetëm nga ana e kreditorit dhe si e tillë nuk mund të ekzekutohet. Më tutje ka shtuar se në faturë nuk është theksuar afati kohor i pagesës si dhe nuk përmban elementet e domosdoshme ku përfshihet edhe arsyeja e faturimit, gjegjësisht përshkrimi i sasisë së mallrave ose shërbimeve të shitura. I ka propozuar gjykatës që të aprovet si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbartimit dhe të abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura të debitorit në prapësim, duke theksuar se të njëjtat kanë për qëllim vetëm prolongimin e pagesës së borxhit dhe se këto pretendimet nuk mbështeten në asnjë provë konkrete. Më tutje ka shtuar se fatura përbën dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal si dhe është nënshkruar me vulë të protokollit nga debitori dhe atë me numër të protokollit 06-422/01-196737/21 të datës 17.09.2021. Në lidhje me pretendimet e debitorit se nuk janë përshkruar sasia e mallrave dhe shërbimeve edhe ky fakt nuk qëndron, ngase në faturë shihet qartë përshkrimi për ofrim të shërbimeve për Ndërtim të Impiantit e që kreditori i ka ofruar debitorit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi dhe të detyrohet debitori që t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe në seancën dëgjimore, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 10/2021 e datës 17.09.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 10/2021 të datës 17.09.2021 e cila faturë i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara punimet të cilat kanë qenë objekt i kontratës me numër 616-19-5495-521, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori dhe e njëjta është paguar pjesërisht.

Në rastin konkret rezulton se Fatura Nr 10/2021, në vlerë prej 21,776.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 17.09.2021 dhe e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, e cila evidentohet përmes vulës së protokollit Nr. 06-422/01-196737/21 të datës 17.09.2021.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se në faturën e kreditorit nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se një pretendim i tillë nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë dhe e njëjta ka arritur afatin për përmbushje në datën e lëshimit.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i' a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përfaqësim në seancën dëgjimore dhe atë në shumën prej 270.40 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur pas mbajtjes së seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.656/22, datë 10.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.